

Propozim:

Në bazë të nenit 7, paragrafi 3 të Ligjit për veprimtaritë komunale ("Gazeta zyrtare e RM-së" numër 95/12) dhe Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit ("Gazeta zyrtare e RM-së" numër 163/13, 42/14, 44/15 dhe 147/15), nenit 5 paragrafi 1 pika.(4) dhe nenit 12 paragrafi 2, pika (3) të Ligjit për gjelbërim urban ("Gazeta zyrtare e RM-së" numër 11/18), nenit 19 të Ligjit për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e RM-së" numër 38/96 – 64/18) dhe nenit 26 të Statutit të NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup me nr. 02-207/5 të datës 08.02.2016, Këshilli drejtues i NP "Parqe dhe gjelbërime" – Shkup, në seancën e mbajtur më datën 27.12.2018 solli:

VENDIM për miratim

Neni 1

KD e shqyrtoi përmbajtjen e Programit për ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të sipërfaqeve të gjelbërimit për shfrytëzim publik në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2019 me nr. 08-2896/1 të datës 25.12.2018.

Neni 2

Miratohet Programi për ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të sipërfaqeve të gjelbërimit për shfrytëzim publik në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2019 me nr. 08-2896/1 i datës 25.12.2018.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Arsyetim

Në pajtim me dispozitat ligjore, ndërmarrja publike është e detyruar që të përpiloj programin vjetor për ndërtim, mirëmbajtje dhe shfrytëzim të sipërfaqeve të gjelbërimit për shfrytëzim publik në territorin e qytetit të Shkupit, i cili në vete i përfshin të dhënat për aktivitetet e parapara të punës, numrin e nevojshëm të realizuesve dhe mbulimin e të tërësishëm financiarë për realizimin e të njëjtit. Për këtë arsye, programin e përpiluar të ndërmarrjes për vitin 2019, drejtori e dorëzoi para këshillit drejtues për shqyrtim dhe miratim. Pas miratimit të tij nga këshilli drejtues, programi do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Këshilli drejtues e shqyrtoi dhe e miratoi vendimin sikur në dispozitivin.

Dorëzuar deri te:

- Arkivi
- Shërbimet profesionale
- Kryetari i KD
- Drejtori
- Themeluesi

**NP "PARQE DHE GJELBËRIME"-SHKUP
Kryetar i Këshillit Drejtues**

Daniella Nikollova